



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel/Fax 04 22268141; 22268142

Nr. 1366/2 Prot.

Tiranë, më 10.11.2017

V E N D I M

Nr.232, datë 10/11/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 170, datë 30.12.2016, "Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 605/1 prot., datë 10.10.2016", në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 170, datë 30.12.2016, "Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 605/1 prot., datë 10.10.2016", në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave,

Vërej se:

Me Urdhrin nr. 605/1 prot., datë 10.10.2016, "Për verifikimin e informacionit të ardhur nga nëpunësja *****", në pozicionin e punës, "Specialist" në Sektorin e Financës, Shërbimeve dhe Publikimeve", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka filluar hetimin administrativ, në lidhje me disa pretendime të ngritura për zhvillimin e procedurës së ecurisë disiplinore për punonjësen *****", në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 170, datë 30.12.2016, "Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 605/1 prot., datë 10.10.2016", të Komisionerit, në të cilin është vendosur:

1. Të kërkoj nga autoriteti publik, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe e Markave, të drejtojë procesin e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të aktit nr. 329 prot, datë 16.09.2016, "Për marrjen e masës disiplinore "Vërejtje",

ndaj nëpunëses *****”, “Specialiste në Sektorin e Financave, Shërbimeve dhe Publikimeve”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave, duke vendosur anulimin e këtij akti, si një akt i dalë në kapërcim të kompetencave dhe në kundërshtim me procedurën.

2. Njësia e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave duhet të fshijë masën disiplinore nga dosja personale e nëpunëses Erjola Reçi dhe nga regjistri përkatës dhe të njoftojë njësinë përgjegjëse, Departamentin e Administratës Publike, në lidhje me këtë veprim administrativ.
3. Institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave duhet të vijojë me pagimin e shtesës së pagës për nëpunësen *****”, për shkak të natyrës së veçantë të pozicionit të punës, nga data e lindjes së kësaj të drejte, e cila i është njohur dhe miratuar nga Departamenti i Administratës Publike dhe Ministria e Financave.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmëruar Nr. 170, datë 30.12.2016, “Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 605/1 prot., datë 10.10.2016”, me Urdhrin nr. 1366 prot., datë 10.07.2017, “Për verifikimin e zbatimit të Vendimit Nr. 170, datë 30.12.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim, u ngrit grupi i punës i përbërë nga Stela Ndoka dhe Helga Peti, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Verifikimi u realizua në datën 13.07.2017, nëpërmjet vizitës në institucionin e Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave, njoftuar për fillimin e këtij procesi, nëpërmjet shkresës nr. 1366/1 prot., datë 10.07.2017, “Njoftim për fillimin e verifikimit”.

Nga komunikimi me titullarin e institucionit *****”, u vumë në dijeni të faktit se personi i ngarkuar për administrimin e dosjeve të personelit, *****”, në momentin e verifikimit nuk ndodhej në institucion, për shkak të një udhëtimi jashtë shtetit. Për këtë arsye, dokumentacioni që materializon zbatimin e Vendimit i është dërguar në mënyrë elektronike grupit të verifikimit nga Përgjegjësjë e Sektorit të Financës, Shërbimeve dhe Publikimeve, *****”.

Pas verifikimit të dokumentacionit shkresor të administruar në dosje rezultoi se:

Në pikën 1 të vendimit objekt verifikimi, Komisioneri ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 329 prot, datë 16.09.2016, “Për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunëses *****”, “Specialiste në Sektorin e Financave, Shërbimeve dhe Publikimeve”, pranë këtij institucioni, duke vendosur anulimin e këtij akti, si një akt i dalë në kapërcim të kompetencave dhe në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji.

Në shkresën nr. 45 prot., datë 23.01.2017, “Mbi zbatimin e Vendimit Nr. 170, datë 30.12.2016”, drejtuar Departamentit të Administratës Publike dhe për dijeni Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave është shprehur se ka filluar marrjen e masave për zbatimin e Vendimit Nr. 170, datë 30.12.2016, të Komisionerit.

Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e verifikimit të këtij rasti rezulton se akti nr. 329 prot, datë 16.09.2016, “Për marrjen e masës disiplinore “Vërejtje”, ndaj nëpunëses *****”, nuk është anuluar. Nga komunikimi verbal me *****”, u pretendua se masa disiplinore “Vërejtje” e dhënë nga Përgjegjësjë e Sektorit të Financës, ***** ndaj nëpunëses *****”, nuk ishte miratuar prej tij si eprori direkt në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe për këtë arsye ajo masë nuk ka prodhuar asnjë efekt, e si e tillë nuk është reflektuar në dosjen personale të nëpunëses *****”. Për këtë arsye, nuk ka qenë e nevojshme marrja e masave për fshirjen e saj nga dosja personale, sikundër ishte lënë detyrë nga Komisioneri në pikën 2 të Vendimit objekt verifikimi.

Arsyetimi i ***** për arsyet e mosveprimit të autoritetit publik që ai përfaqëson, Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave për të konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 329 prot, datë 16.09.2016, nuk është i mbështetur në ligj. Siç është argumentuar edhe në Vendimin paralajmëruar Nr. 170, datë 30.12.2016, të Komisionerit, ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, përcakton qartë se kur një akt administrativ është absolutisht i pavlefshëm, cilat janë pasojat e pavlefshmërisë së tij dhe detyrimin e organit publik për ta konstatuar atë nëse vjen në dijeni. Konkretisht, neni 111 i këtij ligji parashikon sa vijon:

“Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi.”

Në doktrinën juridike është i gjithëpranuar fakti se vullneti shtetëror shfaqet nëpërmjet një forme të caktuar të të shprehurit, që është akti administrativ. Referuar ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, e konkretisht nenit 98 të tij:

“1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ ka formë të shkruar në letër ose elektronike, verbale, ose çdo formë tjetër të përshtatshme.

...

3. Organi publik është i detyruar të konfirmojë pa vonesë përmbajtjen e aktit verbal, në formë të shkruar në letër ose elektronike.”, duke iu përmbajtur kërkesave formale të përcaktuara në nenin 99 të këtij Kodi.

Sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave duhet të bëjë kujdes që në të ardhmen të zbatojë me përpikmëri ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit.

Ndërkohë, nga ana e institucionit janë marrë të gjitha masat për pagimin e shtesës së pagës për nëpunësen *****, për shkak të natyrës së veçantë të pozicionit të punës “Specialiste në Sektorin e Financave, Shërbimeve dhe Publikimeve”, nga data e lindjes së kësaj të drejte, materializuar kjo me urdhrin nr. 58, datë 31.01.2017, “Zbatimin e shtesës në pagë për natyrën e veçantë të punës të nëpunëses *****”, ashtu sikundër është lënë detyrë në pikën 3 të vendimit të Komisionerit.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 170, datë 30.12.2016, “Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 605/1 prot., datë 10.10.2016”, të Komisionerit, vlerësojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave dhe njësia e burimeve njerëzore të këtij institucioni kanë zbatuar rekomandimet e lëna në vendimin paralajmërues objekt verifikimi.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregulloren “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit për zbatimin e Vendimit Nr. 170, datë 30.12.2016, “Mbi përfundimin e procedimit administrativ filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 605/1 prot., datë 10.10.2016”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, duke zbatuar rekomandimet e Vendimit Nr. 170, datë 30.12.2016.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA